



NJOFTIM

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në Statutin e UT-së të miratuar me Urdhërin Nr. 816, datë 26.12.2018 të MASR, kërkon të punësojë në vendin e lirë të punës për personel Ndhmës Akademik me karakter Administrativ me kohë të plotë pranë Njesisë Kryesore si më poshtë:

Kandidatët që konkurojnë për “**Specialist Mësimor**” në **Degën e Sekretarisë dhe e procesit mësimor** duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Master i Shkencave, Master Profesional ose DIND.
2. Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të komunitetit të BE-së.
3. Të njohë programet bazë kompjuterike.
4. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
5. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje.
6. Të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të ketë minimumi 2 (dy) vite eksperiencë pune.

Kandidatët që aplikojnë për këtë vend pune duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës që aplikon;
2. Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV-Curriculum Vitae);
3. Diplomë dhe listë notash për të gjitha ciklet e studimeve universitare (të notuar). Për diplomat e marra në universitete të huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e notuar e certifikatës së njohjes nga strukturat përgjegjëse përkatëse ;
4. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj (të notuar);
5. Të paktën një referencë nga punëdhënësi i fundit;
6. Kopje e librezës së punës dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore;
7. Raport mjeko-ligjor për aftësinë në punë;
8. Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
9. Dëshmi e zotërimit të programeve bazë kompjuterike;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



10. Dëshmi penaliteti ose formular vetëdeklarim;

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejpërdrejta.

Afati i dorëzimit të dokumentave është nga data **09/10/2023 – 23/10/2023**.